

HISTORIKU I SHKOLLËS “HASAN PRISHTINA”

Shkolla fillore në Llugaxhi daton që nga 20 Prilli i vitit 1924.

Mësimi është zhvilluar në gjuhën serbe deri në klasën e katërt.

Ndërkaq nga shtatori i vitit 1941 filloi të zhvillohej mësimi në gjuhën shqipe, falë të Madhit Ernest Koliqi, i cili në atë kohë ishte Ministër i Arsimit dhe për shkollimin shqip kishte derguar më shumë se 200 mësues.

Në shkollën tonë Mësuesi i Parë ishte Kadri Breca nga Elbasani, i cili punoi vetëm 3 muaj.

Punën e tij e vazhdoi Mësuesi vendas Isuf Islami deri në Vitin Shkollor: 1944/'45.

Është me rëndësi të përmendet se shkolla është ndërtuar me vetkontribut të fshatarëve dhe në të zhvillohet mësimi që nga shtatori i vitit 1994.

SHFMU: “HASAN PRISHTINA”, gjendet në Fshatin Llugaxhi të Komunës së Lipjanit.

Llugaxhia ka një pozitë të përshtatshme gjeografike. Nëpër territorin e saj kalon Magjistranja, gjë që ia mundëson lidhjet më të mira me të gjitha rajonet, regjionet europiane e më gjerë.

Shkolla ka 7 dhoma mësimi, sallën e arsimtarëve dhe bibliotekën në të cilën janë të vendosura edhe mjetet dhe instrumentet e laboratorit të Kimisë dhe Biologjisë, e cila shërben për nxënësit e kësaj shkolle dhe që ka një numër të konsiderueshëm librash dhe instrumentesh.

Krahasuar me vitet e kaluara ka rënie të vazhdueshme të numrit të nxënësve,

kështu në vitin 2014 kishte 298 nxënës,

në vitin 2015 kishte 248 nxënës,

në vitin 2016 kishte 248 nxënës,

në vitin 2017 kishte 231 nxënës ,

në vitin 2018 kishte 219 nxënës,

në vitin 2019 kishte 221 nxënës,

në vitin 2020 kishte 200 nxënës,

në këtë vit 2021 kemi 195 nxënës!

Në shkollën tonë janë 13 mësues me bazë në shkollën dhe 7 mësues të angazhuar me bazë në shkollat tjera, janë 4 punëtorë ndihmës, nuk ka pedagog e as psikolog.

Shkollën tonë punon në dy ndërrime, ndërrimi i paradites, ku mësimi fillon prej orës 8:00 dhe ndërrimi i pasdites, ku mësimi fillon në ora 13:15.

Kemi aktivitet të të gjitha organeve në shkollë, zhvillojmë bashkëpunim të mirë me institucionet si DKA dhe MASHT.

Është shkollë me traditë të punës dhe mësimi, duke pasur parasysh se fshati ka një numër të madh intelektualësh, pothuajse nga të gjitha profilet arsimore.